



## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

### KARTË - TEKNOLOGJIKE

#### **“Rehabilitimi i Agrumishteve të dëmtuara nga ngricat (Rezultate të studimit një vjeçar)”.**

Në muajin Janar 2017, vendi ynë u përfshi nga temperatura ekstremisht të ulta përfshirë edhe jugun e Shqipërisë ku temperaturat arritën deri në  $-10^{\circ}\text{C}$  deri në  $-12^{\circ}\text{C}$ . Agrumet janë shumë të ndjeshme ndaj ngricave krahasuar me drufrutorët e tjerë apo edhe me Ullirin, ajo fillon të tronditet në  $-2-3^{\circ}\text{C}$  ndërsa në temperaturat e sipërpermendura ajo pëson dëmtime serioze deri në tharje totale.

Pas ngricave doli domosdoshmeri evidentimi i kultivarëve dhe nënshartesave më rezistente me qëllim që t'u vijmë në ndihmë fermerëve duke ju rekomanduar kultivarët më të qëndrueshëm në rastet kur ata do të krijojnë një parcelë me agrume apo edhe fermerët që prodhojnë fidana agrume të përdorin kultivarin dhe nënshartesën e përshtatëshme për kushtet e zonës së tyre. Gjithashtu ti këshillojmë Fermerët për shërbimet agroteknike që duhet të kryejn për reabilitimin e Agrumeve në rast përsëritje të situatës sinoptike të 2017.

Që konkluzionet të ishin sa më të sakta ndoqëm hecurinë e kultivarëve dhe reabilitimin e tyre në QTTB Vlore dhe në një Fermë private Sarandë.

E ndoqëm këtë kërkim edhe në BEP Shamogjin për vet faktin se në koleksionin e agrume janë tre specie agrume, Portokalle, Manderina dhe Limona me mbi 30 kultivarë të moshës 7 vjeçare mbi pesë nënshartesa të ndryshme dhe konkluzionet e dëmtimeve nga ngricat janë më të sakta dhe me të plota

Nga monitorimi që bë gjatë muajit Shkurt- Mars tek të gjitha speciet dhe kultivarët e agrumeve u pa se ishte dëmtuar masa gjethore dhe pjesa më madhe e degëve skeletore. Në disa kultivarë dhe bimë të vecanta ishin dëmtuar dhe degët kryesore.

-Në muajin Prill u bë evidentimi i dëmtimeve për cdo specie, kultivarë dhe nënshartesë

- U pa shkalla e dëmtimit të tyre

- Shkalla e parë: Dëmtimi i masës gjethore( përzhitje e gjetheve)









- Shkalla e dytë: Dëmtimi i degëve skeletore

- Shkalla e tretë, dhe më e rëndë sigurisht dëmtimi i trungut dhe degëve kryesore.

Në përgjithësi Agrumet, patën dëmtim të masës gjethore, u vyshkën, morën ngjyrë kafe dhe u rezuan më vonë. Pjesa më e madhe çelën dhe u zhvilluan normalisht në varësi të kultivarit dhe nënshartesës përkatëse. Nuk u rigjeneruan më ata kultivarë që patën dëmtime të trungut dhe degëve kryesore .

Sipas specieve qëndrueshmëria ndaj ngricave rezultoi si më poshtë:

## Limoni:

		
<p>Sfusato Amalfinato/Mars</p>	<p>Sfusato Amalfinato/Nentor</p>	<p>Fminello/Mars</p>
		
<p>Feminello/ Nentor</p>	<p>Meyer/ Mars</p>	<p>Nëntor</p>
		
<p>Hibrid Trakle/Mars</p>	<p>Nëntor</p>	<p>Lunario VCR</p>
	<p><b>Konkluzione: (Limon)</b>            Duke parë dhe fotot e mësipërme arrijmë në konkluzion se: Në kushtet e zonës së Shamogjinit kur temperaturat arrijnë -12°C, në përgjithësi kultura e limonit nuk ishte rezistente. Qëndrueshmëri të mirë kishte kultivari Sfusato Amalfinato/nerenxë, dhe qëndrueshmëri të ulët kultivari Feminello /nerënx, Hibrid Trakle dhe Meyer tek te cilat kanë rezistuar vetëm nga një ose dy bimë. Kultivarët e tjerë janë tharë plotësisht dhe nuk kanë më mundësi rigjenerimi</p>	
<p>Interdonato</p>		





**Figurë 1.** Pamje nga Koleksioni i Agrumeve (Limon; Portokalle)



## Konkluzione (Portokalle)

Në përgjithësi Portokallet janë të qëndrueshme ndaj ngricave .

- Me qëndrueshmëri të ulët është kultivari Valencia Olinda i cili u tha tërsisht mbi të gjitha nënshartesat si dhe Navelina S/A/Nerënxë si dhe Navelina /Nerënxë.


- Me qëndrueshmëri mesatare dhe të mirë rezultojnë gjithë Navelinat e tjera si dhe W.Navel. Ces 3093.

- Po ashtu dhe Tarocot në tërsi të cilat çelën , u zhvillan mirë dhe prodhuan fruta.

- Përsa i përket kultivarit Moro Nuc vihet re çarje të lekurës së trungut gjë që mund të sjelli pasoja negative në zhvillimin e mëtejshëm të bimëve.

- Me qëndrueshmëri të lartë rezultoi kultivari Lane Late.

## Specia Manderinë



Figurë 2. Pamje nga Koleksioni i Agrumeve (Manderina).

## Konkluzione: (Manderinë)

Nga studimi që ju bë kultivarëve rezulton se Manderinat janë të qëndrueshme ndaj ngricave. Sipas rezistencës së tyre klasifikohen si më poshtë:

- Nuk janë rezistent kultivarët Avana Apirena mbi të gjitha nënshartesat si dhe Clementina Comune /Nerënxë të cilat janë tharë plotësisht.

Tharë plotësisht edhe Satsuma /Nerënxë.

Satsuma Myagawa/Nerënxë dhe Trifoljatë 50%, e kurorës është e tharë dhe bimët janë të dobëta.

- Me qëndrueshmëri të lartë janë gjithë kultivarët e tjerë mbi të gjitha nënshartesat si Clementina Spinosa, Clementina Comune, Clementina Corsica, Hernandina, Tangelo Novo të cilat në kushtet e këtij viti patën një prodhim mesatar (foto më lartë).

Është e rëndësishme të theksojmë se të gjitha bimët e tre specieve kanë patur qëndrueshmëri me të mirë mbi nënshartesën Swingle Citrumelo të cilat pas ngricave patën një zhvillim të bujshëm të kurorës.

- Duke parë shkallën e dëmtimit u percaktua dhe mënyra e krasitjes dhe gjithë shërbimet e tjera agroteknike.

### **Teknologjia e përdorur për rehabilitimin e Agrumeve :**

-Kujdes i veçant u tregua me **krasitjen**, nuk duhen bërë ndërhyrje të menjëhershme pas ngricave por pasi shihet qartë shkalla e dëmtimit dhe reagimit të çdo kultivari. Në këtë mënyrë shmangëm prerjet e rënda, të panevojshme dëmtimin e skeletit dhe kurorës së bimës.



**Figurë 3.** Pamje nga bimët e dëmtuara nga ngricat.

-U përdor **plehrim i gjelbër** (Bathë), në një pjesë të Manderinave e cila u përmbys me anë të punimit në kohën e lulëzimit.





**Figurë 4.** Pamje nga kryerja e shërbimeve agroteknike në koleksionin e Agrumeve..

- **U plugua dhe frezua;** gjithë sipërfaqja në pranverë.
- **Punim me bel;** rreshtat e agrumeve të shoqëruara me pleh kimik DAP dhe Superfosfat - 3 herë në pranverë dhe në vjeshtë.
- **Vaditje** me pika gjatë gjithë verës në çdo 10 ditë.
- **Plehrim** me Ure dhe Nitrat të shoqëruara me ujitje 3 herë.

Siç shihet edhe në fotot më poshtë në fund të vitit të parë, kemi një parcelë Agrume plotësisht të rehabilituar.



**Figurë 5.** Në parcelën e Fermerit Jetmir Mehmeti

Ndodhet në fshatin Bamatat - Delvinë, me sipërfaqe 1.5 ha dhe me numër bimësh 1100 rrënjë manderina Klementinë të moshës dy vjeçare nga të cilat 550 bimë mbi nënshartesën Nerënxë dhe pjesa tjetër mbi nënshartesën Trifoljatë. Mbi nënshartesën Trifoljatë bimët patën qëndrueshmëri të lartë ndaj ngricave ndërsa mbi nënshartesën Nerënxë kultivari Clementinë rezultoi me qëndrueshmëri shumë të ulët, tharje në masë të bimëve. Ishte kjo arsyeja ta bënim kërkimin pikërisht në këtë parcelë të Fermerit Jetmir Mehmeti, ku dukshëm vihej re qëndrueshmëria e të njëjtit kultivarë mbi dy nënshartesë të ndryshme.

Studimi u ngrit në tre varjante si më poshtë:

V.1 Rehabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar vetëm masa gjethore me anë të shërbimeve agroteknike.

V.2 Rehabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar një pjesë e degëve skeletore dhe trungut, nëpërmjet krasitjes dhe shërbimeve të tjera agroteknike.

V.3 Shkulje e bimës së dëmtuar dhe zëvendësimi me bimë të re.

Treguesit që u morrën:

- Rritja e diametrit të trungut në muajt (Prill-Nëntor).

- Rritja mesatare e lastarëve dhe volumi i kurorës në muajt (Prill-Nëntor).

Në gjithë agrumishten për të tre varjantet u bënë shërbimet si më poshtë:


- **Vaditje;** me pika shoqëruar me **plehra** të tretshëm në ujë (sipas bilancit të hartuar), 2 herë në javë.

- **Spërkatje;** 1 herë në javë kundër tenjës Minuese dhe dëmtuesve të tjerë.

**Punim dhe frezim;** 1 herë në gjithë sipërfaqen.

Në fund të muajit Nëntor u bën matjet për marrjen e treguesve sipas metodikës dhe sipas varjanteve kemi këto rezultate:

### V1: Rehabilitimi i bimëve që u është dëmtuar vetëm masa gjethore.



**Grafiku Nr. 1** Të dhëna të rritjes së diametrit të trungut dhe lartësisë (Prill; Nëntor).

Siç shihet nga grafikët por edhe nga fotua bimët që ju dëmtuan vetëm gjethet të cilat morën ngjyrë kafe dhe më vonë u rrëzuan, u rigjeneruan totalisht, e gjithë kurora u mbush me gjelbërim të ri, patëm rritje lastarësh 5-8 cm dhe diametër të trungut 6-9 cm.

## V2. Rehabilitimi i bimëve që u janë dëmtuar degët skeletore dhe trungu.

Në këtë varjant u pa që bimët dy vjeçare të kultivarit Klementina/Nerënxë që patën dëmtim të shkallës së dytë u thanë, nuk u rigjeneruan më me gjithë shërbimet agroteknike që u përmendën më sipër. (Foto poshtë).



Figura Nr. 6 Nënshartesë Nerënxë e rehabilituar pas ngricave.


## V3. Shkulje e bimës së dëmtuar dhe zëvendësimi me bimë të re.

U mendua që një pjesë e Mandarinave/Nerënxë të shkulej dhe të zëvendësohej me fidanë të ri mbi nënshartesën Trifoljatë.



Figurë 7. Fidanë i mbjellë në Prill

Nëntor




Grafiku Nr. 2 Të dhëna të rritjes së diametrit të trugut dhe lartësisë (Prill; Nëntor).



Siç shihet nga fotot dhe grafikët fidani i rimbjellë ka rritje të bujshme në gjithë kurorën nga muaji Prill deri në muajin Nëntor, diametri nga 18 mm në 32 mm dhe lartësia e bimës nga 107 cm në 136.6cm.

Bima e mbjellë në pranverë në fund të vitit të parë ( Varianti 3), pati një zhvillim të mirë duke ju afruar treguesve të rritjes së bimëve të rehabilituara (Varianti 1).



**Grafiku 3.** Të dhëna krahasuese midis varianteve.

#### **Konkluzione:**

- Në zonën e Delvinës, kultivari Clementinë mbi Trifoljatë në agrumishte të re ka qëndrueshmëri të lartë ndaj ngricave, ndërsa mbi nënshartesën Nerënxë ka qëndrueshmëri të ulët, prandaj rekomandojmë të mbillen sa më pak fidanë mbi këtë nënshartesë pasi ka nënshartesa të tjera me qëndrueshmëri shumë të lartë siç janë Sw.Citrumelo dhe Cintrazhet në përgjithësi.
- Kur kemi të bëjmë me dëmtime të shkallës së parë nuk duhet të shqetësohemi pasi me rritjen e temperaturave dhe nëpërmjet shërbimeve agroteknike këto bimë janë plotësisht të riparueshme
- Nëse kemi dëmtime të shkallës së tretë (janë dëmtuar degët skeletore dhe trungu), është më ekonomike të shkulen dhe të rimbillen me fidanë, pasi fitojmë kohë në rinovimin total të Agrumishtes. Por, kjo nuk do të thotë që të ndërmarrim vendime të nxituara për vetë koston që ka ky proces.

**Specialist:**

**Lida Lazaj**